




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT SEMAN



VENDIM

Nr.2, datë 24.02.2022

PËR

MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”, SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike, subjektit “Balkan Green Energy” sh.p.k., me vendndodhje, përroi i Nikolicës, degë e lumit Devoll, Bashkia Devoll, Qarku Korçë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

HEC Nikolica

Vepra e marrjes

- X=567315.69
- Y=4480598.8
- Z=1388 m.m.n.d

Godina e Centralit

Pika e shkarkimit

- X=568988.66
- Y=4482651.77
- Z=1199 m.m.n.d

- $Q_{mes}=0.22 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{llog}=0.45 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{eko}=0.017 \text{ m}^3/\text{s}$

- Fuqia max e instaluar $N_{max}= 700 \text{ kW}$
- Energjia Vjetore $E=1,619,300 \text{ kW/vit}$

3. Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Instalimi i stacioneve duhet të bëhet brenda datës 31.3.2022 sipas afatit të vendosur në kontratën e porosisë “Kontratë për furnizim” me subjektin “Hydro Invest” sh.p.k, në të kundërt pushohet fuqia juridike e vendimit.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

